



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

RREGULLORE (QRK) NR. 33/2024 PËR TË DREJTËN E RABATIT¹

¹ Rregullorja (QRK) Nr. 33/2024 për të Drejtën e Rabatit, është miratuar në mbledhjen e 230-të, të Qeverisë së Republikës së Kosovës me Vendimin Nr. 14/230, të datës 13.11.2024;

Qeveria e Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 93 (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në pajtim me nenin 19 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 08/L-202 për Kinematografinë, nenin 8, paragrafi 4, nën-paragrafi 4.5 i Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës,

Nxjerr:

RREGULLORE (QRK) NR. 33/2024 PËR TË DREJTËN E RABATIT

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave për ushtrimin e të drejtës së rabatit për investimet e huaja direkte në prodhimin e veprave filmike dhe audio-vizuale në territorin e Republikës së Kosovës.

Neni 2 Fushëveprimi

1. Kjo rregullore përcakton procedurën, përgjegjësitë, kriteret dhe kërkesat për ushtrimin e të drejtës së rabatit për institucionet publike përgjegjëse dhe operatorët ekonomikë.
2. Dispozitat e kësaj rregulloreje janë të obligueshme për të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës si institucione përgjegjëse për zbatimin e rregullave të rabatit të përcaktuara me këtë rregullore.

Neni 3 Përkufizimet

1. Për qëllim të kësaj rregulloreje, shprehjet e përdorura kanë këtë kuptim:

1.1. **QKK** - Qendra Kinematografike e Kosovës;

1.2. **Rabat** - nënkupton skemën e rimbursimeve financiare për personat juridikë të huaj, të cilët realizojnë vepra filmike apo audio-vizuale në Republikën e Kosovës, përmes investimeve financiare nga jashtë;

1.3. **Film apo vepër filmike** - nënkupton një vepër me pamje me apo pa zë, si filmin e luajtur, animuar dhe dokumentar të çdo metrazhi dhe zhanri;

1.4. **Vepër audio-vizuale** - nënkupton një vepër si: filmin, filmin eksperimental, prodhimin filmik multimedial dhe transmedial, serialin filmik, video-lojërat dhe çdo vepër tjetër me pamje dhe me apo pa zë, pavarësisht teknologjisë me të cilën është krijuar dhe mënyrës së shfaqjes;

1.5. **Prodhim filmik apo audio-vizual** - nënkupton procesin e përgjithshëm të prodhimit dhe aktivitetet e ndërmarra që nga faza e zhvillimit të konceptit, zhvillimit të projektit, paraprodhimit, prodhimit, pasprodhimit, shfaqjes, distribuimit dhe promovimit të veprës;

1.6. **Fond publik** – mbështetja publike financiare për prodhimet filmike dhe audio-vizuale që burojnë nga skemat e përkrahjes së institucioneve publike të Republikës së Kosovës;

1.7. **Entiteti biznesore** – çdo person juridik duke përfshire edhe bizneset individuale;

1.8. **Investitori i huaj** – producenti i huaj i cili investon mjete financiare në vepra audio-vizuale me qëllim të shfrytëzimit të rabatit nëpërmjet një entiteti biznesor vendas;

1.9. **Staf vendor/ praktikantë** – persona fizikë që kanë shtetësi dhe janë banorë rezidentë të Republikës së Kosovës;

1.10. **Video-lojëra** - përfshijnë Extended reality (XR), Augmented Reality (AR), Virtual Reality (VR), Mixed Reality (MR) dhe projekte të ngjashme audio-vizuale;

1.11. **Serial filmik** - nënkupton veprën audio-vizuale të ndarë në episode, siç janë serialet televizive;

1.12. **Gaming**: përfshin veprimin ose praktikën e luajtjes së video-lojërave, të cilat mund të përfshijnë zhanre dhe platforma të ndryshme. (ISO/IEC 19770-1);

1.13. **Video Games**: janë lojëra elektronike që përfshijnë ndërveprimin me pajisje hyrëse për të gjeneruar reagime vizuale për një lojtar. (ISO/IEC 15897);

1.14. **Extended Reality (XR)**: është një term ombrellë për të gjitha teknologjitë imerse, duke përfshirë AR, VR dhe MR. (ISO/IEC JTC 1/SC 24);

1.15. **Augmented Reality (AR)**: është një teknologji që mbivendos përmbajtje digjitale mbi botën reale në kohë reale. (ISO/IEC JTC 1/SC 24);

1.16. **Virtual Reality (VR)**: është një përvojë e simuluar që krijon një mjedis plotësisht imersiv përmes syzeve VR. (ISO/IEC JTC 1/SC 24);

1.17. **Mixed Reality (MR)**: është një përzierje e botëve fizike dhe digjitale, duke lejuar ndërveprime në kohë reale. (ISO/IEC JTC 1/SC 24);

1.18. **Videoklip muzikor**: është film apo video e shkurtë që prodhohet për të përcjellur dhe promovuar një këngë apo një audiovepër në formë vizuale;

1.19. **Video-reklama**: reklamë, përmbajtje apo reklamë televizive që promovon një produkt ose shërbim;

1.20.**Storyboard**: është një seri ilustrimesh të renditura në mënyrë kronologjike që tregojnë ngjarjet kryesore të një filmi, seriali, reklame ose video tjetër, për të planifikuar dhe vizualizuar sekuencat dhe skenat. (ISO/IEC 15938).

Neni 4

Të drejtat dhe kushtet për rabat

1. Investimet e huaja në prodhim audio-vizual kanë të drejtë në rimbursim prej 30 për qind (30%) të shpenzimeve të pranueshme, të shpenzuara drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës sipas kushteve të përcaktuara në këtë rregullore dhe pa përfshirë tatimin mbi vlerën e shtuar.
2. Prodhimet audio-vizuale që marrin mbështetje financiare nga fondi publik i Republikës së Kosovës, përveç investimeve të huaja, kanë të drejtën për rabat me kusht që ky financim të shpenzohet tërësisht në Republikën e Kosovës.
3. Prodhimi audio-vizuel që është përfitues i fondeve publike, duke përfshirë rabatin, sipas paragrafit 1 të këtij Neni, mund të pranojë më së shumti pesëdhjetë për qind (50%) të buxhetit të përgjithshëm të prodhimit audio-vizuel. Në rast se përfitimi nga fondi publik kalon njëzet për qind (20%) pa e shfrytëzuar të drejtën e rabatit, tejkalimi zbritet proporcionalisht në përqindjen e rabatit.
4. Ministria përgjegjëse për kulturë dhe institucioni përkatës për kinematografi, do të ekzekutojë rabatin sipas Paragrafit 1 të këtij Neni, në euro (€) dhe do t'i transferojë operatorit përfitues ekonomik mjetet në llogarinë e bankare në Republikën e Kosovës dedikuar vetëm për prodhimin audio-vizuel, sipas kontratës së rabatit.
5. Prodhimi audio-vizual, të cilit i është garantuar rabati në momentin e nënshkrimit të kontratës, do të kualifikohet për dispozitën e importit të përkohshëm siç rregullohet me legjislacionin përkatës doganor për mallrat jo-kosovare të destinuara për rieksporim, pa pësuar asnjë ndryshim, përveç amortizimit normal për shkak të përdorimit të tyre.
6. Në rastin e serialeve televizive dhe video-lojërave, sezonave të reja dhe përditësimet madhore të versioneve kryesore të prodhimit audio-vizual, I jepet e drejta për të aplikuar në procedurë të re dhe do të merret parasysh si prodhimit i ri sipas kësaj rregulloreje.
7. Vepra audio-vizuale përfituese e rabatit duhet të njoh kontributin e Qendrës Kinematografike të Kosovës dhe Republikës së Kosovës në të gjitha materialet e prodhuara fizikisht dhe online, si dhe në të gjitha kopjet e produktit audio-vizual. Deklarata e mirënjohjes duhet të shfaq dukshëm logot e institucioneve krahas mbishkrimit: “Përkrahur nga Republika e Kosovës përmes rabatit për produktin audio-vizual” në fund të banerit. Në rastet kur klauzola e mirënjohjes nuk mund të aplikohet sipas formës tradicionale, si në rastet e prodhimeve afat-shkurtëra siç janë videot muzikore, reklammat dhe video-lojërat, si dhe vepra të tjera audio-vizuale, atëherë klauzola e mirënjohjes duhet të përfshihet në platformat online të publikimit siç janë Youtube, Vimeo dhe/ose në platforma të tjera audio-vizuale.

Neni 5

Kriteret e përzgjedhjes së aplikantit

1. Aplikanti për rabat duhet të jetë i regjistruar në Republikën e Kosovës për prodhime audio-vizuale.
2. Aplikanti mund të jetë:
 - 2.1. Entitetet biznesore vendore për prodhime audiovizuale;
 - 2.2. Filial i një entiteti biznesor të huaj të prodhimeve audio-vizuale.
3. Aplikanti duhet të jetë i regjistruar në QKK, në regjistrin e prodhuesve të veprave audio-vizuale.
4. Aplikanti duhet të përmbushë të gjitha obligimet ndaj Administratës Tatimore të Kosovës.
5. Aplikanti duhet të dëshmojë se producenti kryesor mund të sigurojë vërtetimin e të drejtës së autorit për prodhimin audio-vizual përkatës nga subjektet që mbajnë të drejtat përkatëse të autorit.
6. Aplikanti duhet të dëshmojë disponueshmërinë e të paktën pesëdhjetë për qind (50%) të mjeteve financiare për përfundimin e prodhimit dhe njëqind për qind (100%) të investimit të huaj në Kosovë. Buxheti i planifikuar i prodhimit duhet të përfshijë investimet e huaja në Republikën e Kosovës. Aplikimet që kanë pranuar fond publik të Republikës së Kosovës përmes institucioneve tjera publike, përveç investimeve të huaja, duhet të ofrojnë një pasqyrë të detajuar se si synohet të shfrytëzohen këto fonde publike në Republikën e Kosovës.
7. Aplikanti duhet të dëshmojë se ka shfaqur publikisht të paktën një (1) vepër audio-vizuale në kinema, festivale, TV, ose platforma të tjera publike gjatë tre (3) viteve të fundit. Nëse entiteti biznesor i aplikantit nuk ka një historik të mjaftueshëm në fushën përkatëse audio-vizuale, do të merren në konsideratë portfoliot e producentëve kryesor të huaj dhe atij vendor.
8. Aplikanti dhe partnerët përkatës (bashkëproducentët ose entiteti biznesor/subjekti kontraktues), duhet të dëshmojnë se nuk janë në proces të parafalimentimit, falimentimit, në proces gjyqësor dhe/ose në proces të likuidimit.
9. Aplikanti nuk duhet të jetë aktualisht në proces ose të ketë ndonjë detyrim të papaguar ndaj institucioneve publike të Republikës së Kosovës.
10. Producenti kryesor vendor dhe drejtori i entitetit biznesor vendor, duhet të dëshmojnë se nuk kanë qenë të dënuar për asnjërën nga veprat penale në vijim: mashtrim, mashtrim në veprimtarinë e biznesit ekonomik, pranim ryshfeti, ofertë ryshfeti, keqpërdorim në procedurat e prokurimit, evasion fiskal ose, mashtrim me subvencione, pastrim parash, keqpërdorim të detyrës zyrtare, trajtim preferencial të paligjshëm, tregtimi i ndikimit, vepra penale të organizuara, siç përcaktohet nga Kodi Penal i Republikës së Kosovës.

11. Aplikanti është i detyruar të respektojë normat minimale të standardizuara të pagave të përcaktuara për stafin lokal, siç përshkruhet në Aneksin 1.

12. Aplikanti duhet të punësojë të paktën pesë (5) praktikantë vendas për projekte afatgjata dhe dy (2) praktikantë vendas për çdo prodhim audio-vizual të mesëm ose të shkurtër në një nga departamentet profesionale për të kuptuar dhe mësuar plotësisht procesin e atij departamenti, si dhe rolet në fushën audio-vizuale, duke përfshirë: departamentin ligjor, financat, departamentin e artit, departamentin e dizajnit të video-lojërave, departamentin e prodhimit, departamentin e redaktimit, departamentin e kostumeve, departamentin e kamerës, ndriçimit dhe kontrollit teknik, departamentin e animacionit dhe efekteve vizuale, departamentin e zërit, dhe departamentit të mbikëqyrësit të skenarit, zhvillim të video-lojërave, dizajnerit konceptual të video-lojërave, animatorëve dhe ndihmës regjisorëve.

13. Aplikanti duhet të ofroj dëshmi të zotimit për sigurim të plotë të prodhimit, duke përfshirë, por jo vetëm, mbulimin e punonjësve për të gjithë kastin dhe ekipin lokal.

Neni 6

Kriteret e përzgjedhjes së prodhimit audio-vizual

1. Prodhimet audio-vizuale që kualifikohen për rabat janë filmat artistikë, dokumentarë, filma të animuar, filma televizivë, seriale filmash, video-lojëra ose vepra të tjera audio-vizuale të përcaktuara nga legjislacioni që rregullon fushën e kinematografisë, të prodhuar pjesërisht ose tërësisht në Republikën e Kosovës.

2. Prodhimet audio-vizuale që nuk kualifikohen për rabat janë: xhirime të inskenuara, ngjarje sportive, çështje aktuale politike ose sociale, emisione me përbërje bisedën, programe demonstrimi, programe vlerësimi, programe roze dhe emisione të tipit “reality show”.

3. Prodhimi audio-vizual, sipas Paragrafit 1 të Nenit 4, duhet të synohet për shfaqje publike siç përcaktohet në Ligjin për Kinematografinë.

4. Shuma minimale e investimeve të huaja, sipas Paragrafit 1 të Nenit 4, që planifikohet të shpenzohet drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës, duke përjashtuar tatimin mbi vlerën e shtuar, të prodhimit audio-vizual përkatës, duhet të jetë:

4.1. Për një projekt të metrazhit të gjatë mbi gjashtëdhjetë (60) minuta:

4.1.1. filmi artistik, njëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë (175.000.00) euro;

4.1.2. film dokumentar, shtatëdhjetë e pesë mijë (75.000.00) euro;

4.1.3. film i animuar, njëqind mijë (100.000.00) euro;

4.1.4. film eksperimental, shtatëdhjetë e pesë mijë (75.000.00) euro;

4.1.5. film transmedial, shtatëdhjetë e pesë mijë (75.000.00) euro;

4.1.6. film multimedial, shtatëdhjetë e pesë mijë (75.000.00) euro;

4.1.7. episode e serialit televiziv, njëqind mijë (100,000.00) euro;

4.1.8. video-lojëra të formës së gjatë dhe projekte të tjera të ngjashme audio-vizuale, njëqind mijë (150,000.00) euro.

4.2.Për një projekt të metrazhit të mesëm nga tridhjetë (30) deri në gjashtëdhjetë (60) minuta:

4.2.1. filmi artistik, shtatëdhjetë e pesë mijë (75.000.00) euro;

4.2.2. film dokumentar, gjashtëdhjetë mijë (60.000.00) euro;

4.2.3. film i animuar, shtatëdhjetë e pesë mijë (75.000.00) euro;

4.2.4. film eksperimental, gjashtëdhjetë mijë (60.000.00) euro;

4.2.5. film transmedial, gjashtëdhjetë mijë (60.000.00) euro;

4.2.6. film multimedial, gjashtëdhjetë mijë (60.000.00) euro;

4.2.7. episode e serialit televiziv, shtatëdhjetë e pesë mijë (75.000.00) euro;

4.2.8. video-lojëra të formës së mesme dhe projekte të tjera të ngjashme audio-vizuale, shtatëdhjetë e pesë mijë (75.000.00) euro.

4.3.Për një projekt të metrazhit të shkurtë deri në tridhjetë (30) minuta:

4.3.1. filmi artistik, njëzet mijë (20.000.00) euro;

4.3.2. videoklip muzikor, njëzet mijë (20.000.00) euro;

4.3.3. video-reklamë, njëzet mijë (20.000.00) euro;

4.3.4. film dokumentar, njëzet mijë (20.000.00) euro;

4.3.5. episode e serialit televiziv, pesëdhjetë (50.000.00) mijë euro;

4.3.6. film i animuar, shtatëdhjetë e pesë mijë (75.000.00) euro;

4.3.7. film eksperimental, gjashtëdhjetë mijë (20.000.00) euro;

4.3.8. film transmedial, gjashtëdhjetë mijë (20.000.00) euro;

4.3.9. film multimedial, gjashtëdhjetë mijë (20.000.00) euro;

4.3.10. video-lojëra të formës së shkurtë dhe projekte të tjera të ngjashme audio-vizuale, njëzet mijë (20.000.00) euro.

5. Prodhimi audio-vizual nuk duhet të reflektojë negativisht në Republikën e Kosovës, të cenojë normat ligjore dhe/ose parimet kushtetuese të Republikës së Kosovës ose të synojë që të nxisë luftë, urrejtje racore, pornografi, terrorizëm, apo çfarëdo aktiviteti tjetër kriminal, siç përcaktohet nga legjislacioni përkatës.

Neni 7 **Kërkesat e aplikimit**

1. Kërkesa për aplikim për rabat, që mund të jetë në mënyrë fizike apo elektronike, duhet të dorëzohet në QKK dhe duhet të përfshijë:

1.1. Formularin e Aplikimit, të plotësuar (Aneksi 2);

1.2. Skenari ose trajtimi dhe/ose storyboard-i i prodhimit audio vizual;

1.3. Plani dinamik i prodhimit;

1.4. Plani financiar i përgjithshëm i prodhimit, duke përfshirë burimet e financimit;

1.5. Ndarja e përgjithshme e parashikuar e buxhetit për gjithë prodhimin, duke përfshirë kostot e para-prodhimit, kostot e prodhimit dhe kostot e pas prodhimit;

1.6. Buxheti i detajuar i parashikuar për shpenzimet që do të harxhohen në Republikën e Kosovës, sipas aplikimit për rabat;

1.7. Rrjedha e përgjithshme e parashikuar e fluksit të parave të prodhimit, duke përfshirë të ardhurat dhe shpenzimet;

1.8. Konfirmimi i regjistrimit të biznesit të entitetit vendor;

1.9. Marrëveshja ndërmjet entitetit biznesor vendas dhe investitorit të huaj;

1.10. Konfirmimi i regjistrimit nga QKK;

1.11. Konfirmimi tatimor i Kosovës;

1.12. Marrëveshja për të drejtën e autorit;

1.13. Dëshmi e mjeteve në dispozicion, që përputhen plotësisht me listën e të gjitha burimeve të financimit të artikuluar përkatësisht në nën-paragrafit 1.5 dhe 1.7 të Nenit 7;

1.14. Dëshmi e shfaqjes publike të të paktën një (1) vepre audio-vizuale, duke përfshirë, por pa u kufizuar, në kontratat dhe vegëzat online të veprat audio-vizuale. Për shembull, shpërndarje

kinematografike teatrale, festivale filmi, platforma të transmetimit, TV apo platforma të tjera publike gjatë tre (3) viteve të fundit sipas Paragrafit 7 të Nenit 5;

1.15. Pasqyrat financiare të auditimit, bilancet dhe dokumentet e tjera ligjore që vërtetojnë se aplikanti nuk është në proces parafalimentimi, falimentimi, në proces gjyqësor dhe/ose në proces likuidimi;

1.16. Dëshmi e subjekteve partnere që vërteton nuk kanë ndonjë detyrim të papaguar ndaj institucioneve publike të Republikës së Kosovës (Aneksi 3), përveç kontratave në proces të zbatimit;

1.17. Çertifikata e gjendjes penale ose dëshmi/informata e gjendjes penale;

1.18. Dëshmi që sigurimet e prodhimit audiovizual do të jenë në fuqi deri në nënshkrimin e kontratës së rabatit në rast të miratimit;

1.19. Deklarata nën betim për vërtetësinë e dokumentacionit të dorëzuar.

2. Aplikimet mund të dorëzohen në gjuhën shqipe, serbe ose angleze.

3. Për të gjitha dokumentet përkatëse të kërkuara, mund të dorëzohet dokumenti origjinal ose një kopje e noterizuar e dokumentit origjinal. Dokumentet e lëshuara nga institucionet publike janë të përkthyer nga gjuha origjinale në anglisht, shqip ose serbisht, kopja e përkthyer duhet të jetë e vëlosur nga përkthyesi i certifikuar.

Neni 8 **Komisioni për rabat**

1. Komisioni për rabat përbëhet nga shtatë (7) anëtarë, duke përfshirë;

1.1. një (1) zyrtar ligjor nga QKK ose nga Ministria përkatëse për kulturë;

1.2. dy (2) zyrtarë financiarë nga QKK ose nga Ministria përkatëse për kulturë;

1.3. dy (2) profesionistë të pavarur të fushës së kinematografisë;

1.4. dy (2) profesionistë të fushës së video-lojërave.

2. Anëtarët nga nënparagrafi 1.1 dhe 1.2 janë të përhershëm ndërsa anëtarët nga nënparagrafi 1.3 dhe 1.4 marrin pjesë vetëm në trajtimin e aplikimeve që kanë të bëjnë me fushën që e mbulojnë.

3. Shoqatat e Producentëve të Kosovës për Kinematografi dhe shoqata përkatëse për video-lojëra, duhet të nominojnë nga dy (2) anëtarë secila. Anëtarët marrin pjesë gjatë vlerësimit të aplikimeve për rabat - për filma artistikë, filma dokumentarë, filma të animuar, filma televizivë, seriale filmike dhe projekte të tjera të ngjashme audio-vizuale, ndërsa, profesionistët e nominuar për video-lojëra marrin pjesë gjatë vlerësimit të aplikimeve për rabat - për video-lojëra ose projekte të tjera të ngjashme audio-vizuale.

4. Drejtori i QKK-së duhet të caktoj komisionin për rabat me vendim.
5. Komisioni për rabat ka mandat prej tre (3) vjetësh.
6. Përgjegjësitë kryesore të komisionit për rabat, janë:
 - 6.1. Pranimi i aplikimeve për rabat;
 - 6.2. Vlerësimi i dokumentacionit të aplikimeve dhe rekomandimi i dhënë Drejtorit për miratim ose refuzim të aplikimit për rabat. Vlerësimi dhe Rekomandimi jepet, përmes raportit të vlerësimit. Në rast të rekomandimit për refuzim, komisioni për rabat do të shfaq mangësitë e aplikimit përaktës dhe arsyet e refuzimit bazuar në kriteret e vlerësimit;
 - 6.3. Komunikimi me aplikantin për çështje që ndërlidhen me rabat;
 - 6.4. Hartimi i dokumenteve ligjore që ndërlidhen me rabat, përfshirë, por jo kufizuar, në kontratën e rabatit;
 - 6.5. Menaxhimi i kontratave të rabatit dhe rekomandimi për veprime të mëtejshme për menaxhmentin e lartë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe kushtet e kontratës përkatëse;
 - 6.6. Vlerësimi i raporteve përfundimtare dhe veprave audio-vizuale të përfituesve të rabatit dhe rekomandimi për veprime të mëtejshme te Drejtori i QKK-së, në përputhje me legjislacionin dhe kushtet e kontratës përkatëse;
 - 6.7. Mirëmbajtja e databazës së aplikimeve dhe përfituesve të rabatit;
 - 6.8. Dorëzimi i raportit vjetor që përfshin të dhëna si: numri i aplikimeve, numri i projekteve të aprovuara dhe të refuzuara, investimi total i huaj për vit, rimbursimi total i parasë për vit, numri i personave të punësuar, numri i praktikantëve të punësuar, sasia e mjeteve të mbledhura përmes tarifave për aplikim, numri dhe vendet e lokacioneve të filmuara, dhe informacione të tjera relevante;
 - 6.9. Zbatimi i kësaj rregulloreje dhe legjislacioneve të tjera që lidhen me rabat, financa publike, etj.
7. Anëtarët e komisionit për rabat, kompensohen për punën e tyre.
8. Mënyra dhe shuma e kompensimit të komisionit për rabat përcaktohet me vendim të drejtorit të QKK-së bazuar në legjislacionin përkatës në fuqi.
9. Nëse njëri nga anëtarët e komisionit për rabat duhet të vlerësojë një aplikim që mund të përmbajë konflikt personal të interesit, duhet të njoftojë Drejtorin e QKK-së dhe të mos marrë pjesë në vlerësimin dhe rekomandimin në lidhje me aplikimin përkatës.
10. Konfliktet e interesit menaxhohen në përputhje me Ligji Nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Neni 9

Procedurat e aplikimit

1. Ekzistojnë dy (2) lloje të procedurave të aplikimit për rabat:
 - 1.1. Procedura standarde;
 - 1.2. Procedura e përsheptuar për projektet audio-vizuale në formë të gjatë.
2. Katër (4) hapa përbëjnë procedurën e aplikimit:
 - 2.1. Dorëzimi i aplikimit dhe dokumentacionit mbështetës nga aplikanti;
 - 2.2. Vlerësimi i formularit të aplikimit dhe dokumentacionit nga komisioni për rabat;
 - 2.3. Vendimi për aplikimin për rabat dhe njoftimi i aplikantit;
 - 2.4. Nënshkrimi i kontratës ndërmjet aplikantit dhe QKK-së.
3. Gjatë vlerësimit, në bazë të nën-paragrafit 2.2 i këtij Neni, në rast të ndonjë mospërputhjeje, komisioni për rabat mund të kërkojë që dokumentet administrative të plotësohen/ndryshohen.
4. Kur komisioni për rabat kërkon që dokumentet administrative të plotësohen/ndryshohen në bazë të Paragrafit 3 të këtij Neni, aplikanti është i detyruar të dorëzojë dokumentacionin e kërkuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve të punës.
5. Duke iu referuar nën-paragrafit 2.3 i këtij Neni, Drejtori i Qendrës Kinematografike të Kosovës vlerëson rekomandimin nga komisioni për rabat, për të përcaktuar miratimin ose refuzimin e rabatit për aplikimin përkatës, duke lëshuar më pas një vendim në përputhje me të.
6. Aplikanti duhet të njoftohet pas çdo hapi të procedurës së aplikimit për rabat, në bazë të Paragrafit 2 të këtij Neni.
7. Në rast se investimi i huaj pëson rritje pas nënshkrimit të kontratës, aplikanti duhet të njoftojë komisionin për rabat, duke dorëzuar një deklaratë me shkrim, një plan financiar të përditësuar, buxhetin dhe rrjedhën e parasë në bazë të nën-paragrafit 1.4, 1.5, 1.6 dhe 1.7 të Neni 7. Rritja e investimit të huaj që është subjekt i rabatit nuk duhet të tejkalojë mbi njëqind përqind (100%) të shumës fillestare të aprovuar të aplikimit përkatës për rabat, siç përcakohet në paragrafin 3 të nenit 4.
8. Ministria përgjegjëse dhe QKK-ja janë të detyruar të zbatojnë sistemin online të aplikimit për rabat brenda një (1) viti.

Neni 10

Afatet e aplikimit

1. Aplikanti duhet të dorëzojë aplikimin për rabat në QKK, të paktën dy (2) ditë pune para fillimit të prodhimit audio-vizual, sipas nënparagrafit 1.3 të nenit 7.

2. QKK duhet të lëshojë vendimin për aplikim për rabat:

2.1.brenda tetëmbëdhjetë (18) ditëve të punës, për projektet audio-vizuale të formës së shkurtër të procedurës standarde;

2.2.brenda njëzet e tetë (28) ditëve të punës për projektet audio-vizuale të formës së gjatë dhe të mesme të procedurës standarde;

2.3.brenda trembëdhjetë (13) ditëve të punës për projektet audio-vizuale të formës së gjatë për procedurën e përshpejtuar.

3. QKK duhet të njoftojë aplikantin për vendimin e aplikimit për rabat, brenda dy (2) ditëve të punës pas vendimit në bazë të Paragrafit 2 të këtij Neni.

Neni 11 Tarifat e aplikimit

1.Tarifat e aplikimit për rabat janë:

1.1. Dyqind e pesëdhjetë (250.00) euro për projektet audio-vizuale të formës së shkurtër për procedurën standarde;

1.2. Një mijë (1000.00) euro për projektet audio-vizuale të formës së gjatë dhe të mesme për procedurën standarde;

1.3. Dhjetë mijë (10,000.00) euro për projektet audio-vizuale të formës së gjatë për procedurën e përshpejtuar.

Neni 12 Nënshkrimi i kontratës për rabat

1.Para nënshkrimit të kontratës, aplikanti duhet të dorëzojë në QKK dokumentet e mëposhtme:

1.1.Nëse aplikanti ka dorëzuar një marrëveshje paraprake në bazë të nën-paragrafit 1.9 të Neni 7 në fazën e aplikimit, aplikanti duhet të dorëzojë marrëveshjen e plotë ndërmjet entitetit biznesor vendas (aplikantit) dhe investitorit të huaj. Marrëveshja ose kontrata duhet të jenë plotësisht në përputhje me marrëveshjen paraprake ose parakontratën. Nëse një nga partnerët ndryshohet pas dokumentacionit të dorëzuar gjatë fazës së aplikimit për rabat, vendimi për miratim klasifikohet si i pavlefshëm;

1.2.Konfirmimin bankar;

1.3.Dëshmi të sigurimit të projektit (kontrata dhe certifikata) për prodhimin audio-vizual.

2. Aplikanti duhet të dorëzojë dokumentet në bazë të Paragrafit 1 të këtij Neni brenda njëzet (20) ditëve të punës pas vendimit në bazë të Paragrafit 5 të Neni 9.

3. Komisioni për rabat duhet të verifikojë dokumentet në bazë të Paragrafit 1 të këtij Neni dhe të njoftojë aplikantin brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas dorëzimit të dokumenteve përkatëse nga aplikanti.
4. Gjatë verifikimit, në bazë të Paragrafit 3 të këtij Neni, nëse identifikohet ndonjë mospërputhje, komisioni për rabat mund të kërkojë korrigjimin e dokumenteve.
5. Nëse komisioni për rabat kërkon që dokumentet përkatëse të korrigjohen në bazë të Paragrafit 4 të këtij Neni, aplikanti është i detyruar të dorëzojë dokumentacionin e kërkuar brenda pesë (5) ditëve të punës pas njoftimit nga komisioni për rabat. Afati mund të zgjatet deri në dhjetë (10) ditë pune me marrëveshje të ndërsjellë ndërmjet komisionit për rabat dhe aplikantit.
6. Aplikanti mund të kërkojë sqarime nga komisioni për rabat në lidhje me kërkesat në bazë të Paragrafit 4 të këtij Neni.
7. Nëse aplikanti dështon të dorëzojë dokumentet ose nuk përmbush kërkesat e komisionit për rabat, në bazë të Paragrafit 5 të këtij Neni, miratimi për rabat është/konsiderohet i pavlefshëm.
8. Kontrata e rabatit ndërmjet QKK-së dhe aplikantit duhet të nënshkruhet brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas njoftimit nga komisioni për rabat. Afati mund të zgjatet deri në njëzet (20) ditë pune me marrëveshje të ndërsjellë ndërmjet QKK-së dhe aplikantit.
9. Nëse prodhimi i projektit zgjatet përtej afatit të planifikuar për përfundim sipas nënparagrafi 3 të Nenit 7, aplikanti duhet të kërkojë zgjatjen e kontratës për rabat, si më poshtë:
 - 9.1. për projekte të metrazhit të shkurtë, tre (3) muaj para skadimit të kontratës;
 - 9.2. për projekte të metrazhit të mesëm, gjashtë (6) muaj para skadimit të kontratës;
 - 9.3. për projekte të metrazhit të gjatë, një (1) vit para skadimit të kontratës.
10. Zgjatja e kontratës për rabat nuk duhet të kalojë kohëzgjatjen e kërkuar dhe të miratuar fillimisht në afatin e dorëzimit të prodhimit.
11. Një shabllon i kushteve të përgjithshme të kontratës ndërmjet QKK-së dhe aplikantit është paraqitur në Aneksin 3.

Neni 13

Procedura e rimbursimit për projektet audio-vizuale të formës së gjatë

1. Rabati, sipas Paragrafit 1 të Nenit 4 për projektet audiovizuale të formës së gjatë mund të ekzekutohet nën kushtet e mëposhtme:

1.1. Njëzet e shtatë përqind (27%) e shpenzimeve të pranueshme, respektivisht nëntëdhjetë përqind (90%) e shumës totale të rimbursimit, duhet të ekzekutohet brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve të punës pas njoftimit nga komisioni për rabat kundrejt raportit përfundimtar të prodhimit audio-vizual në bazë të Nenit 15;

1.2. Pesëmbëdhjetë përqind (15%) e shpenzimeve të pranueshme, respektivisht pesëdhjetë përqind (50%) e shumës totale të rimbursimit, mund të ekzekutohet pasi të jetë nënshkruar kontrata e rabatit dhe aplikanti të ketë paraqitur konfirmimin bankar nga banka vendore që vërteton disponueshmërinë e pesëdhjetë përqind (50%) të mjeteve të investimit të huaj, të destinuar për shpenzim në Republikën e Kosovës për prodhimin përkatës të prodhimit audio-vizual. PAGESA duhet të ekzekutohet brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve të punës pas paraqitjes së kërkesës nga aplikanti dhe pas miratimit nga menaxheri i kontratës në QKK;

1.3. Tre përqind (3%) e shpenzimeve të pranueshme, respektivisht dhjetë përqind (10%) e shumës totale të rimbursimit, duhet të ekzekutohet brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve të punës pas aprovimit nga komisioni për rabat kundrejt skedarëve përfundimtarë të prodhimit audio-vizual në bazë të Nenit 16.

2. Numri i kësteve për ekzekutimin e rabatit, sipas Paragrafit 1 të Nenit 4, është subjekt i kontratës së rabatit, dhe mund të jetë deri në tre (3) këste.

3. Menaxheri i kontratës është i obliguar të shqyrtojë kërkesën për pagesë brenda dhjetë (10) ditëve të punës për aprovim të kërkesës ose për ta kthyer për përmirësime sipas nevojës.

4. Nëse raporti përfundimtar zbulon se investimet e huaja të shpenzuara direkt në Republikën e Kosovës janë më të ulëta se shuma e aprovuar nga komisioni i rabatit, komisioni duhet të rekomandojë që Drejtori të aprovojë fondin e rabatit, të zvogëluar, për shpenzimet e pranueshme. Fondi përfundimtar i investimeve duhet të përmbushë kriteret minimale në bazë të Paragrafit 4 të Nenit 6. Në rast që shuma finale e investimit të huaj nuk përputhet me shumën minimale, përfituesi i rabatit detyrohet të bëjë kthimin e të gjitha mjeteve të pranuar deri në atë pikë dhe i anulohet kontrata e rabatit.

5. Nëse investimi i huaj i shpenzuar direkt në Republikën e Kosovës është më i lartë se fondi i aprovuar i rabatit, në bazë të Paragrafit 5 të Nenit 9, komisioni për rabat do të vlerësojë raportin përfundimtar dhe do t'i sugjerojë Drejtorit aprovimin e çdo rritjeje në fondin e rabatit, për shpenzimet e pranueshme. Megjithatë, rritja e rabatit nuk duhet të kalojë mbi njëqind përqind (100%) shumën e aprovuar fillimisht të aplikimit përkatës për rabat që është subjekt i Paragrafit 3 të Nenit 4.

6. Nëse Paragrafi 5 i këtij Neni aktivizohet, shuma e rabatit do të ekzekutohet brenda njëzet e pesë (25) ditëve të punës pas miratimit të rabatit.

7. Ekzekutimi i pagesave të rabatit mund të bëhet vetëm ndërmjet 1 Marsit dhe 23 Dhjetorit të çdo viti fiskal.

Neni 14

Procedura e rimbursimit për projektet audio-vizuale të formës së shkurtër dhe të mesme

1. Rabati, sipas Paragrafit 1 të Nenit 4 për projektet audio-vizuale të formës së shkurtër dhe të mesme, mund të ekzekutohet nën kushtet e mëposhtme:

- 1.1. Tridhjetë përqind (30%) e shpenzimeve të pranueshme, respektivisht njëqind përqind (100%) e shumës totale të rimbursimit, duhet të ekzekutohet brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve të punës pas njoftimit nga komisioni për rabat, kundrejt raportit përfundimtar në bazë të Nenit 15 dhe materialet përfundimtare master të prodhimit audio-vizual në bazë të Nenit 16.
2. Numri i kësteve për ekzekutimin e rabatit, sipas Paragrafit 1 të Nenit 4, është subjekt i kontratës së rabatit dhe mund të jetë deri në një (1) këst.
3. Nëse raporti përfundimtar zbulon se investimet e huaja të shpenzuara direkt në Republikën e Kosovës janë më të ulëta se shuma e aprovuar nga komisioni për rabat, komisioni do të rekomandojë që Drejtori të aprovojë fondin e rabatit, të zvogëluar, për shpenzimet e pranueshme. Fondi përfundimtar i investimeve duhet të përmbushë kriteret minimale në bazë të Paragrafit 4 të Nenit 6. Në rast që shuma finale e investimit të huaj nuk përputhet me shumën minimale, përfituesi i rabatit detyrohet të bëjë kthimin e të gjitha mjeteve të pranuar deri në atë pikë dhe i anulohet kontrata e rabatit.
4. Nëse investimi i huaj i shpenzuar direkt në Republikën e Kosovës është më i lartë se fondi i miratuar i rabatit, në bazë të Paragrafit 5 të Nenit 9, komisioni për rabat do të vlerësojë raportin përfundimtar dhe do t'i sugjerojë Drejtorit miratimin e çdo rritjeje në fondin e rabatit, për shpenzimet e pranueshme. Rritja e rabatit nuk duhet të tejkaloj shumën e miratuar fillimisht sipas aplikimit përkatës për rabat dhe është subjekt i Paragrafit 3 të Nenit 4. Megjithatë, rritja e rabatit nuk duhet të kalojë mbi njëqind përqind (100%) shumën e aprovuar fillimisht të aplikimit përkatës për rabat që është subjekt i Paragrafit 3 të Nenit 4.
5. Nëse Paragrafi 4 i këtij Neni aktivizohet, shuma e rabatit do të ekzekutohet brenda njëzet e pesë (25) ditëve të punës pas aprovimit të rabatit.
6. Ekzekutimi i pagesave të rabatit mund të bëhet vetëm ndërmjet 1 marsit dhe 23 dhjetorit të çdo viti fiskal.

Neni 15

Raporti përfundimtar

1. Raporti përfundimtar duhet të përfshijë:

1.1. Një raport përmbledhës të prodhimit, duke përfshirë treguesit kryesorë të performancës si Gjinia, Mosha, Aftësitë e Kufizuara, Etnia, LGBTQ+, numri total i të punësuarve nga Kosova me detaje për pozitën dhe kohëzgjatjen e punësimit, numri i praktikantëve nga Kosova të punësuar, me detaje për kohëzgjatjen dhe departamentin ku kanë punuar, vendet e xhirimit duke përfshirë dhe adresën;

1.2. Një përshkrim të detajuar të kostove për fondet publike dhe raportin e kostove kundrejt buxhetit të shpenzimeve të përgjithshme të shpenzuara direkt në Republikën e Kosovës në bazë të aplikimit për rabat;

1.3. Deklaratat bankare konform raportit të kosotove dhe vërtetimet e transaksioneve bankare;

- 1.4.Kontratat e të punësuarve , fletë-oraret e plotësuarra për të gjithë praktikantët, faturat dhe kuponët fiskalë;
 - 1.5.Konfirmimi tatimor nga Administrata Tatimore e Kosovës;
 - 1.6.Raportin e Auditorëve të Certifikuar për të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet në Republikën e Kosovës;
2. Të gjitha transaksionet bankare duhet të bëhen përmes llogarisë bankare të dedikuar për Prodhimin, në bazë të nënshkrimit të kontratës sipas Paragrafit 4 të Nenit 4.
 3. Komisioni për rabat duhet të vlerësojë raportin përfundimtar në bazë të Paragrafit 1 të këtij Neni dhe të njoftojë aplikantin e rabatit mbi rezultatin, brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas datës së dorëzimit.
 4. Gjatë vlerësimit të raportit përfundimtar, në rast të ndonjë mospërputhjeje, komisioni për rabat mund të kërkojë korrigjimin e dokumenteve administrative të aplikimit. Komisioni për rabat duhet të vlerësojë raportin përfundimtar të korrigjuar dhe të njoftojë përfituesin e rabatit për rezultatin, brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas datës së dorëzimit.

Neni 16

Dorëzimi i materialeve përfundimtarë për prodhimin audio-vizual

- 1.Materialet përfundimtare për prodhimin audio-vizual të formës së gjatë përfshijnë:
 - 1.1.Një kopje të prodhimit final audio-vizual të dorëzuar përmes linkut të shfaqjes ose linkut të platformës së publikuar;
 - 1.2.Posterin përfundimtar në formatin JPG, PDF dhe TIFF për qëllime promovuese;
 - 1.3.Një version Pro Res dhe MP4 të përmbledhjes së shkurtër të prodhimit audio-vizual për qëllime promovuese.
2. Materialet përfundimtare për prodhimin audio-vizual të formës së shkurtër dhe të mesme përfshijnë:
 - 2.1.Një kopje të prodhimit final audio-vizual të dorëzuar përmes linkut të shfaqjes ose linkut të platformës së publikuar;
 - 2.2.Posterin përfundimtar në formatin JPG, PDF dhe TIFF për qëllime promovuese (nëse aplikohet);
 - 2.3.Një version Pro Res dhe MP4 të përmbledhjes së shkurtër të prodhimit audio-vizual për qëllime promovuese (nëse aplikohet).

3. Komisioni për rabat duhet të vlerësojë materialet përfundimtare të prodhimit audio-vizual në bazë të Paragrafit 1 të këtij Neni dhe të njoftojë aplikantin për rabat mbi rezultatin, brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas datës së dorëzimit.

Neni 17

Shpenzimet e pranueshme

1. Shpenzimet e pranueshme për rabat i janë nënshtruar Paragrafit 1 të Nenit 4 dhe duhet të shpenzohen sipas Aneksit 4 të cilat duhet të përfshijnë burimet njerëzore, shërbimet dhe mallrat e përdorura dhe konsumuar në Republikën e Kosovës vetëm për qëllime të prodhimit audio-vizual.

2. Shpenzimet e pranueshme para aplikimit mund të konsiderohen si pjesë e aplikimit për rabat maksimumi vetëm deri në gjashtë (6) muaj para datës së aplikimit të dorëzuar.

Neni 18

Ndërprerja e Kontratës

1. Kontrata për rabat ndërpritet në rast të prishjes së marrëveshjes së plotë mes partnerëve.

2. Nëse aplikanti dhe/ose partnerët e tyre përkatës shkelin këtë rregullore ose legjislacionin përkatës që rregullon fushën e kinematografisë dhe financat publike, kontrata e rabatit do të ndërpritet.

3. Nëse prodhimi për të cilin është aplikuar për rabat anulohet, aplikanti duhet të njoftojë komisionin për rabat dhe kontrata e rabatit do të ndërpritet.

4. Kontrata do të anulohet nëse përfituesi kryesor nuk është në gjendje të përmbushë rolin e tyre pas kontraktimit. Një përjashtim nga kjo dispozitë aplikohet nëse aplikanti kryesor bëhet i paaftë fizikisht ose mendërisht, duke përfshirë rastet e sëmundjes së rëndë ose vdekjes, në këtë rast kontrata mund ndryshohet në emër të producentit të ri kryesor nga entiteti i njejtë biznesor.

5. Nëse kontrata e rabatit ndërpritet pas ekzekutimit të pagesës së parë dhe është subjekt i Paragrafit 1 të Nenit 13, përfituesi është i detyruar të kthejë mjetet e përfituara tek QKK.

Neni 19

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Çdo mosmarrëveshje që rrjedh nga ose në lidhje me këtë rregullore do të zgjidhet miqësisht midis palëve përmes negociatave.

2. Nëse mosmarrëveshja nuk mund të zgjidhet përmes negociatave brenda tridhjetë (30) ditësh, palët bien dakord të paraqesin kontestin në ndërmjetësim në përputhje me rregullat dhe procedurat e Qendrës së Ndërmjetësimit të Odës Ekonomike të Republikës së Kosovës.

3. Nëse mosmarrëveshja nuk zgjidhet përmes ndërmjetësimit brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh nga data e referimit në ndërmjetësim, secila palë mund ta paraqesë kontestin në gjykatat kompetente të Republikës së Kosovës.

4. Gjykata Themelore e Prishtinës ka juridiksion ekskluziv mbi çdo mosmarrëveshje që rrjedh nga ose në lidhje me këtë rregullore.

Neni 20 **Njoftimi për Pezullim të Përkohshëm**

Qendra Kinematografike e Kosovës është e detyruar të lëshojë njoftim publik në rast të një vendimi për pezullimin e përkohshëm të aplikimeve për rabat.

Neni 21 **Shtojcat**

1. Shtojcat e kësaj rregullore do të jenë:

- 1.1. Normat Minimale të Standardizuara;
- 1.2. Formulari i Aplikimit;
- 1.3. Shablloni i kontratës së rabatit;
- 1.4. Shpenzimet e Përshtatshme.

Neni 22 **Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

15/11/2024

SHTOJCA 1 NORMAT MINIMALE TË STANDARDIZUARA

NORMAT MINIMALE PËR KASTIN DHE EKIPIZHIN PËR PROJEKTET AUDIOVIZUALE

Normat minimale për kastin dhe ekuipazhin llogariten në baza ditore përveç nëse përcaktohet ndryshe.

Asnjë anëtar i kastit apo ekuipazhit që punon në një projekt të skemës së rabatit nuk do ta marrë pagesë më të vogël se Paga Minimale Kombëtare në Kosovë.

FILM & TV (DUKE PËRFSHIRË REKLAMAT & VIDEO SPOTET MUZIKORE)		
SKENARI DHE HISTORIA	Formë e gjatë dhe e mesme	Formë e shkurtër
SHKRIMTARI	me negociata	me negociata
REDAKTORI I SKENARIT	100	50
PRODUCENTËT		
BASHKË PRODUCENTËT	me negociata	me negociata
PRODUCENTËT	me negociata	me negociata
PRODUCENTI EKZEKUTIV	me negociata	me negociata
PRODHIMI EKZEKUTIV	me negociata	me negociata
PRODUCENTI I LINJËS	me negociata	me negociata
ASISTENTI EKZEKUTIV	50	30
ASISTENTËT E PRODHIMIT	50	30
REGJISORI DHE KASTI		
REGJISORI	me negociata	me negociata
TRAJNERI I AKTRIMIT/DIALOGUT	100	50
KOREOGRAFËT	100	50
KONSULENTI KREATIV/TEKNIK	100	50
REGJISORI I NJËSISË SË DYTË	me negociata	me negociata
ASISTENTI I REGJISORIT	50	30
DREJTORI I PËRZGJEDHJES SË KASTIT	100	50
ASISTENTI I PËRZGJEDHJES SË KASTIT	50	30
ARTISTI I HISTORISË	100	50
KASTI		
KASTI KRYESOR	150	75
KASTI MBËSHTETËS	100	50
KASTI MYSAFIR	100	50
KOORDINATORI I KASTIT ZËVENDËSUES	150	75
PERFORMUESIT E KASTIT ZËVENDËSUES DHE MEKANIKËT	100	50
KOORDINATORI I INTIMITETIT	100	50
SHOQËRUESIT	50	30
KUJDESTARËT	50	30
PRODHIMI		

MENAXHERI I PRODHIMIT	175	90
ASISTENTI I PARË I REGJISORIT	150	75
ASISTENTI I DYTË I REGJISORIT	125	60
ASISTENTI I TRETË I REGJISORIT	100	50
MBIKËQYRËSI I PRODHIMIT	125	60
KONTABILISTI I PRODHIMIT	150	75
ASISTENTI I KONTABILISTIT TË PRODHIMIT	125	60
KOORDINATORI I PRODHIMIT	125	60
ASISTENTI I KOORDINATORIT TË PRODHIMIT	100	50
SEKRETARI I PRODHIMIT	80	40
ASISTENTËT E ZYRËS SË PRODHIMIT	50	30
ASISTENTËT E PRODHIMIT NË SET	50	30
INSTRUKTORI I STUDIOS/PUNËTORI I MIRËQENIES	50	30
INTERPRETI/PËRKTHYESIT	100	50
STUDENTËT E PRODHIMIT	30	30
STUDENTËT E ASISTENTIT TË REGJISORIT	30	30
PËRZGJEDHJA E KASTIT		
AKTORËT PROVË	70	35
AKTORËT SHITESË NË PRAPAVIJË	30	30
MUZICIENTËT	100	50
INSTRUKTORI/PUNËTORI I MIRËQENIES	50	30
KAMERA		
DREJTORI I FOTOGRAFISË	me negociata	me negociata
OPERATORI I KAMERËS	175	90
KAMERA E PARË ASISTUESE (TËRHEQËSI I FOKUSIT)	150	75
KAMERA E DYTË ASISTUESE	125	60
MBIKËQYRËSI I VAZHDIMËSISË/SKENARIT	125	60
OPERATORI I KAMERËS LËVIZËSE	150	75
FOTOGRAFI I AKTRIMIT	100	50
STUDENTI I KAMERËS	30	30
DIT	150	75
OPERATORI I VIDEO PLAYBACK	125	60
NDRIÇIMI		
KRYE ELEKTRICISTI	175	90
ASISTENTI I KRYE ELEKTRICISTIT	150	75
ELEKTRICISTËT E NDRIÇIMIT	125	60
STUDENTI I NDRIÇIMIT	30	30
OPERATORI I GJENERATORIT	125	60
OPERATORI I KONSOLËS SË DRITAVE	125	60

MEKANIKA		
MEKANIKU KRYESOR	175	90
ASISTENTI I MEKANIKUT	150	75
MEKANIKU I KRANIT / ASISTENTI I OPERATORIT	150	75
ASISTENTI I MEKANIKUT	100	50
STUDENTI I MEKANIKUT	30	30
ZËRIMI		
MIKSER ZËRIMI	175	90
OPERATORI I ZHURMËS	125	60
ASISTENTI I ZËRIMIT	100	50
STUDENTI I ZËRIMIT	30	30
PUNËTORI I AUDIO PLAYBACK	70	35
PUNËTORI I VIDEO ASISTIMIT	70	35
MUZIKA		
KOMPOZITORI	me negociata	me negociata
MBIKËQYRËSI I MUZIKËS	150	75
REDAKTORI I MUZIKËS	125	60
DIZAJNI I PRODHIMIT		
DIZAJNERI I PRODHIMIT	me negociata	me negociata
DREJTORI I ARTIT	150	75
ASISTENTI I DREJTORIT TË ARTIT	125	60
ARTISTI I HISTORISË/ILUSTRUESI	100	50
DIZAJNERËT E SETIT/ARTISTËT GRAFIKË	100	50
KONTABILISTI I ARTIT	70	35
KOORDINATORI I DEPARTAMENTIT TË ARTIT	125	60
ASISTENTI I PRODHIMIT TË DEPARTAMENTIT TË ARTIT	70	35
KRIJUESIT E MODELEVE	100	50
BLERËSI I PAJISJEVE	150	75
KOSTUMOGRAFI I SETIT	100	50
PËRGJEGJËSI I PAJISJEVE MBËSHTETËSE	100	50
ASISTENTI I DEPARTAMENTIT TË ARTIT	50	30
STUDENTËT E DEPARTAMENTIT TË ARTIT	30	30
MJESHTRI I PRONËS	150	75
ASISTENTI I PAJISJEVE MBËSHTETËSE	100	50
PAJISJET MBËSHTETËSE ZËVENDËSUESE	100	50
KOORDINATORI I PAJISJEVE TË PIKTURËS	125	60
NDËRTIMI		
MENAXHERI I NDËRTIMIT	150	75
KOORDINATORI I NDËRTIMIT	125	60

ARTISTËT E SKENËS	100	50
MBIKËQYRËSI	100	50
SUVATUESIT	100	50
PUNËTORËT E HEKURIT	100	50
ZDRUKHTARËT	100	50
INTERPRETI	100	50
DEKORUESI I SETIT	100	50
KOSTUMOGRAFI NË SET	100	50
INTERPRETI/PA	100	50
BLERËSI I DEPARTAMENTIT TË ARTIT	125	60
KAFSHËT		
KUJDESTARI I KAFSHËVE	100	50
TRAJNERI I KAFSHËVE	100	50
KOSTUMET/GARDEROBA		
DIZAJNERI I KOSTUMEVE	me negociata	me negociata
MBIKËQYRËSI I GARDEROBËS	150	75
ASISTENTËT E KOSTUMEVE	100	50
BLERËSI I KOSTUMEVE	125	60
STUDENTI I KOSTUMEVE	30	30
INTERPRETI	100	50
EFEKTET SPECIALE		
MENAXHERI I EFEKTEVE SPECIALE	150	75
KOORDINATORI I EFEKTEVE SPECIALE	125	60
KRYEPERSONI I EFEKTEVE SPECIALE	100	50
ASISTENTI I EFEKTEVE SPECIALE	70	35
KOORDINATORI I DEPARTAMENTIT TË EFEKTEVE SPECIALE	125	60
INTERPRETI	100	50
ARMËPUNUESI	150	75
KRIJUESI I MODELEVE	100	50
FLOKËT DHE GRIMI		
ARTISTI KRYESOR I GRIMIT	150	75
ARTISTI I DYTË I GRIMIT	125	60
ARTISTI I GRIMIT	100	50
STILISTI KRYESOR I FLOKËVE	150	75
ASISTENTI I STILISTIT TË FLOKËVE	125	60
STUDENTI I GRIMIT	30	30
GRIMI PËR EFEKTE TË VEÇANTA	150	75
AUTOMJETET		
KOORDINATORI I TRANSPORTIT	125	60

VOZITËSI KRYESOR	100	50
VOZITËSIT - KAMIONË/RIMORKIO	70	35
VOZITËSIT - FURGONË/VETURA	70	35
ASISTENTI I PRODHIMIT PËR TRANSPORT	50	30
LOKACIONET		
MENAXHERI I LOKACIONIT	150	75
KËRKUESI I LOKACIONIT	100	50
MENAXHERI I NJËSISË	125	60
ASISTENTI I LOKACIONIT	50	30
STUDENTI I LOKACIONIT	30	30
INFERMIERI APO DOKTORI I LICENCUAR	50	30
EFEKTET VIZUALE		
PRODHUESI I EFEKTEVE VIZUALE	150	75
MBIKËQYRËSI I EFEKTEVE VIZUALE	125	60
KOORDINATORI I EFEKTEVE VIZUALE	100	50
ARTISTI I EFEKTEVE VIZUALE	125	60
FAZA PAS PRODHIMIT		
MBIKËQYRËSI PAS PRODHIMIT	150	75
KOORDINATORI PAS PRODHIMIT	125	60
ASISTENTI PAS PRODHIMIT	50	30
HULUMTUESI	50	30
PËRKTHYESI	100	50
REDAKTIMI		
REDAKTORI	me negociata	me negociata
ASISTENTI I REDAKTORIT	100	50
ASISTENTI I DYTË I REDAKTORIT	70	35
STUDENTI I REDAKTIMIT	30	30
ZËRIMI PAS PRODHIMIT		
DIZAJNERI I ZËRIMIT	150	75
MENAXHERI I ZËRIMIT	150	75
ARTISTI I ZËRIMIT	125	60
INXHINIERI PARA ZËRIMIT	125	60
INXHINIERI ADR	125	60
PICTURE POST		
SHKALLA	150	75
REDAKTORI ONLINE - RREGULLIMET E PIKTURËS ONLINE, PASTRIMI DHE OPTIKA	125	60
GRAFIKA	100	50
PUBLICITETI		
PUBLICISTI	100	50

FOTOGRAFI I AKTRIMIT	100	50
FOTOGRAFIA SPECIALE	100	50
VIDEOFOTOGRAFI PAS KAMERAVE	100	50
DIZAJNERI I POSTERIT	100	50

DOKUMENTARË		
SKENARI DHE HISTORIA	LFormë e gjatë dhe e shkurtër	Formë e shkurtër
SHKRIMTARI	me negociata	me negociata
HULUMTUESIT	70	35
PRODHUESIT		
BASHKËPRODHUESIT	me negociata	me negociata
PRODHUESIT	me negociata	me negociata
PRODHUESI EKZEKUTIV	me negociata	me negociata
ASISTENTI I PRODHUESIT	100	50
PRODHUESI I LINJËS	me negociata	me negociata
ASISTENTËT E PRODHUESIT	50	30
REGJISORI DHE PËRZGJEDHJA E KASTIT		
REGJISORI	me negociata	me negociata
TRAJNERI I AKTRIMIT/DIALOGUT	100	50
KOREOGRAFËT	100	50
KONSULENTI KREATIV/TEKNIK	100	50
REGJISORI I NJËSISË SË DYTË	me negociata	
ASISTENTI I REGJISORIT	50	30
DREJTORI I PËRZGJEDHJES SË KASTIT	100	50
ASISTENTI I PËRZGJEDHJES SË KASTIT	50	30
ARTISTI I HISTORISË	100	50
KONSULENTI I HISTORISË	100	50
EKSPERTI I INTERVISTAVE/NË EKTRAN	50	30
KONSULENTI/KËSHILLTARI	100	50
KONSULENTI PAS ZHVILLIMIT TË STORJES	50	30
HULUMTUESI	70	35
INTERPRETI DHE PËRKTHYESIT	70	35
KASTI		
KASTI KRYESOR	150	75
KASTI MBËSHTETËS	100	50
KASTI MYSAFIR	100	50
KOORDINATORI I KASTIT ZËVENDËSUES	150	75
PERFORMUESIT E KASTIT ZËVENDËSUES DHE MEKANIKËT	100	50
KOORDINATORI I INTIMITETIT	100	50

SHOQËRUESIT	50	30
KUJDESTARËT	50	30
PRODHIMI		
MENAXHERI I PRODHIMIT	150	75
ASISTENTI I PARË I REGJISORIT	150	75
ASISTENTI I DYTË I REGJISORIT	125	60
ASISTENTI I TRETË I REGJISORIT	100	50
MBIKËQYRËSI I PRODHIMIT	125	60
KONTABILISTI I PRODHIMIT	150	75
ASISTENTI I KONTABILISTIT TË PRODHIMIT	125	60
KOORDINATORI I PRODHIMIT	125	60
ASISTENTI I KOORDINATORIT TË PRODHIMIT	100	50
SEKRETARI I PRODHIMIT	80	40
ASISTENTËT E ZYRËS SË PRODHIMIT	50	25
ASISTENTËT E PRODHIMIT NË SET	50	30
INSTRUKTORI I STUDIOS/PUNËTORI I MIRËQENIES	50	30
INTERPRETI/PËRKTHYESIT	100	50
STUDENTI I PRODHIMIT	30	30
STUDENTI I ASISTENTIT TË REGJISORIT	30	30
PËRZGJEDHJA E KASTIT		
AKTORËT SHITESË NË PRAPAVIJË	30	30
MUZICIENTËT	100	50
INSTRUKTORI/PUNËTORI I MIRËQENIES	50	30
KAMERA		
DREJTORI I FOTOGRAFISË	me negociata	me negociata
OPERATORI I KAMERËS	150	75
KAMERA E PARË ASISTUESE (TËRHEQËSI I FOKUSIT)	125	60
KAMERA E DYTË ASISTUESE	100	50
MBIKËQYRËSI I VAZHDIMËSISË/SKENARIT	100	50
OPERATORI I KAMERËS LËVIZËSE	150	75
FOTOGRAFI I AKTRIMIT	100	50
STUDENTI I KAMERËS	30	30
DIT	125	60
OPERATORI I VIDEO PLAYBACK	125	60
NDRIÇIMI		
KRYE ELEKTRICISTI	150	75
ASISTENTI I KRYE ELEKTRICISTIT	125	60
ELEKTRICISTËT E NDRIÇIMIT	100	50
STUDENTI I NDRIÇIMIT	30	30

OPERATORI I GJENERATORIT	100	50
OPERATORI I KONSOLËS SË DRITAVE	100	50
MEKANIKA		
MEKANIKU KRYESOR	150	75
ASISTENTI I MEKANIKUT	125	60
MEKANIKU I KRANIT / ASISTENTI I OPERATORIT	125	60
ASISTENTI I MEKANIKUT	70	35
STUDENTI I MEKANIKUT	30	30
ZËRIMI		
MIKSER ZËRIMI	150	75
OPERATORI I ZHURMËS	100	50
ASISTENTI I ZËRIMIT	70	35
STUDENTI I ZËRIMIT	30	30
AUDIO PLAYBACK LABOR	70	35
VIDEO ASSIST LABOR	70	35
MUZIKA		
KOMPOZITORI	me negociata	me negociata
MBIKËQYRËSI I MUZIKËS	150	75
REDAKTORI I MUZIKËS	125	60
DIZAJNI I PRODHIMIT		
DIZAJNERI I PRODHIMIT	me negociata	me negociata
DREJTORI I ARTIT	125	60
ASISTENTI I DREJTORIT TË ARTIT	100	50
ARTISTI I HISTORISË/ILUSTRUESI	70	35
